



Pranimi / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received / Delivery	18 - 08 2022	viti god year	
Organ /Njesta Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypje Pilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTIK	4804/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.596/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani -anëtarë, me Avdyll Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.596/2022 të datës 05.07.2022, të parashtruar nga ankuesit të cilin me autorizim e përfaqësoni Avokat me adresë në Lipjan, kundër organit të punësimit Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 18.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e jashtë afatshme ankesa me numër A.nr.596/2022 e datës 05.07.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 05.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 3918/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mos kompensimit të orëve shtesë-heshtjes administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.07.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërsa ky i fundit më datë 14.07.2022 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 3918/2022 e datës 05.07.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 21.06.2022; Urdhër Posti me Nr. 601 i datës 05.09.2019; Vendimin me Nr. 190 i datës 13.03.2019 për formimin e Komisionit për nxjerrje e ditëve të punës të angazhuara nga stafi; Vendimin e datës 26.12.2019 për formimin e

Komisionit për nxjerrje e ditëve të punës të angazhuara nga stafi; Raporti i bilancit të përgjithshëm të orëve jashtë orarit të punës me Nr. 870 i datës 30.12.2019; Raportin me Nr. 197 i datës 13.03.2019; Raport mbi renovimet në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan me Nr. 865 i datës 19.12.2019; Fotografi të renovimeve; Kërkesën me Nr. 594 e datës 27.05.2022 nga ankuesi për Zëvendësuesin e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Kërkesën me Nr. 0263 e datës 04.03.2022 nga ankuesi për Zëvendësuesin e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 14.07.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 14.07.2022; Kontratë Pune për Kohë të Pacaktuar për ankuesin; Përshkrimi i detyrave të punës për Zyrtar Korrektues; Vendimin me Nr. 0765 i datës 24.08.2020 për caktimin e përkohshëm të ankuesit si Mbikëqyrës; Raport mbi të dhënat për vijueshmërinë në punë për ankuesin për vitin 2021; Vendimin me Nr. 1621 i datës 05.12.2018 për caktimin e ankuesit si ushtrues detyre i Mbikëqyrësit; Vendimin me Nr. 4150 i datës 11.11.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka vërtetuar se ankesa e ankuesit, *është palejueshme, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesi në bazë të Kontratës për Punë për Kohë të Pacaktuar të datës 30.06.2020 është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës në pozitën "Zyrtar Korrektues" në Qendrën Korrektuese në Lipjan. I njëjti me Vendimin me numër protokollit 1621 të datës 05.12.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës është caktuar përkohësisht në pozitën e *Ud. Mbikëqyrësit* në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan, i cili vendim është shfuqizuar me Vendimin me numër protokollit 4150 të datës 14.11.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ku serish me Vendimin me numër protokollit 0765 të datës 24.08.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues caktohet mbikëqyrës në Qendrën Korrektuese në Lipjan.

Me tej nga shkresat e lëndës Kolegji gjen se ankuesi është angazhuar në punë shtesë respektivisht në rinovimin e objektit të banimit të të burgosurve në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan, ku sipas Raportit me numër protokollit 197 të datës 13.03.2019 të Komisionit të themeluar sipas Vendimit të datës 13.03.2019 të Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Lipjan, është konstatuar se ankuesit për periudhën nga data 11.07.2018 deri 27.02.2018 ka gjithsej 107 ditë pune shtesë ndërsa sipas Raportit me numër protokollit 870 të datës 30.12.2019 të Komisionit të themeluar sipas Vendimit të datës 26.12.2019 të Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Lipjan është konstatuar se ankuesit për periudhën 21.07.2019 deri më datë 19.12.2019 ka gjithsejtë 814 orë punë me ndërrime.

Ankuesi me datë 04.03.2022 dhe 23.05.2022 ka parashtruar kërkesë të Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës për kompensimin e orëve shtesë për vitin 2018 deri në vitin 2020, mirëpo ankuesi nuk ka pranuar përgjigje në raport me kërkesat si me lartë.

Nga shkesat e lëndës rezulton së kompensimi i orëve shtesë i referohet vitit 2018 dhe 2019, andaj në kuptim të aplikimit të ligjit material Kolegji konston së në këtë periudhë kohore ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës dhe së ankuesi për periudhën nga 05.12.2018 deri 14.11.2019 ka ushtruar pozitën e *Mbikëqyrësit* si pozitë e nëpunësit civil.

Rrjedhimisht, në kuptim të prnaueshemrisë së ankesës Kolegji ju referua nenit 81 Ligji Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës me të cilin është përcaktuar se: *1.Organe të veçanta*



për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë. 2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, si dhe nenit 4 paragrafi 1 i Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave me të cilin është specifikuar se: nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje apo lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës, andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në provat e lëndës Kolegji gjen se ankuesi deri me datë 04.03.2022 nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik ndaj heshtjes së organit të punësimit lidhur me mos kompensimin e orëve shtesë të konstatuara sipas Raportit me numër protokolli 197 të datës 13.03.2019 dhe Raportit me numër protokolli 870 të datës 30.12.2019, kështu që nisur nga këto fakte, rrjedhë se ankesa A.nr.596/2022 e datës 05.07.2022 është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 4 të ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.

Duke marr parasysh rrethanat si me lartë, Kolegji bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.596/2022

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMShCK- së;